


Statistikat e Peshkimit 2020

Tiranë, më 25 Qershor 2021: Në vitin 2020, zënia e peshkut nga të gjitha kategoritë ujore, ka qenë 16.892 tonë nga 15.011 tonë që ishte në vitin 2019, duke shënuar një rritje me 12,5 %.


Fig. 1 Zëniet nga peshkimi gjithsej



Struktura e zënieve sipas kategorive ujore

Kategoritë ujore të peshkimit janë: det, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe. Kategoritë kryesore që zënë përqindjen më të lartë të peshkimit janë, “Akuakultura” me 52,09 % dhe peshkimi “Detar” me 26,76 %, pasuar nga “Ujërat e brendshme” me 16,83 %, ndaj prodhimit gjithsej.

Fig. 2 Struktura e zënieve nga peshkimi sipas kategorive ujore (%)



Për publikim 25/06/2021

Ndryshimet vjetore të zënieve sipas kategorive ujore

Në vitin 2020, rritjen më të madhe e ka shënuar kategoria “Akuakultura” me 68,3 % të zënieve gjithsej, krahasuar me një vit më parë, ndjekur nga kategoria “Bregdeti” me 6,6 % dhe kategoria “Ujërat e brendshme” me 2,6 %.

Kategoria ujore “Molusqe” ka pësuar rënie me 73,47 % në vitin 2020, krahasuar me një vit më parë, pasuar nga kategoria “Peshkimi Detar” me 17,78 %.

Tab. 1 Zëniet nga peshkimi sipas kategorive ujore (tonë)

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020	
Kategoritë ujore						
I	Total Peshkimi (1+2+3+4)	7.884	8.289	8.629	8.707	7.808
1	Detar	4.646	4.609	5.537	5.499	4.521
2	Bregdeti	952	1.074	315	342	365
3	Laguna	598	599	350	94	79
4	Ujërat e brendshme	1.688	2.007	2.427	2.772	2.844
II	Akuakultura	3.200	4.000	5.138	5.229	8.799
III	Molusqe	1.450	430	1.108	1.075	285
Total Zënie (I + II +III)		12.534	12.719	14.875	15.011	16.892

Zëniet sipas specieve kryesore

Në vitin 2020, për sa i përket kategorive ujore, det, bregdet dhe laguna, specia e cila ka rezultuar me përqindjen më të madhe të zënë është “Karkaleci i thellësisë” me 20,7 % ndaj zënieve gjithsej, pasuar nga “Merluc” me 15,1 % dhe “Sardele” me 7,7 %. Përsa i përket zënieve në ujërat e brendshme, specia “Krap” ka përqindjen më të madhe të zënieve gjithsej, me 23,66 %, pasuar nga “Skorta” me 20,75 % dhe specia “Karas” me 17,93 %.

Tab. 2 Zëniet sipas specieve kryesore dhe kategorive ujore

Speciet Detare, Bregdetare, Lagunë	Sasia në tonë
Karkalec i thellësisë	1.026
Merluc	751
Sardele	384
Barbun	333
Açuga	256
Skampi	194
Kallamar	183
Stavrid	171
Ton	169
Oktapod	154
Specie të tjera	1.344
Speciet e Ujërave të brendshme	Sasia në tonë
Krap	673
Skortë	590
Karas	510
Qefull	291
Ballgjer i bardhë	244
Perka ose Sharmak	201
Specie të tjera	335

Flota detare


Në vitin 2020, janë 720 subjekte të liçencuara për të ushtruar aktivitetin e peshkimit. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut). Gjatë vitit 2020 janë regjistruar 69 subjekte më shumë se një vit më parë.

Flota detare sipas porteve të peshkimit

Në vitin 2020, porti me numrin më të madh të anijeve të liçencuara është porti i Durrësit, me 37,78 % të flotës së përgjithshme. Porti i Vlorës ka 31,81 % të numrit të përgjithshëm të flotës, pasuar nga porti i Sarandës me 14,31 %.

Portet e peshkimit me përqindjet më të vogla të subjekteve të liçencuara për peshkim janë ato të, Lushnje-Fier me 2,22 % dhe Himarës me 1,25 %.

Fig. 3 Shpërndarja e flotës detare sipas porteve të peshkimit (%)



Flota detare sipas llojit të anijes

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi. Pjesa më e madhe e flotës sonë është e përbërë nga anije me njica me 68,75 % si dhe anije peshkimi me tërheqje (fundore dhe pelagjike), me 26,53 %, të cilat përdoren kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë. Pjesa tjetër janë anije shumëpërdorimshe dhe anije për qëllime të tjera.

Prodhimi i rasateve

Një fokus të veçantë po i kushtohet ripopullimit të specieve si Koran, Krap dhe Ballgjerë i bardhë si një vëmendje e shtuar dhe ndihmesë për ruajtjen e biodiversitetit. Në vitin 2020 u prodhuan dhe hodhën në liqenin e Ohrit 1,6 milion rasate të Koranit ose rreth 8 % më shumë se në vitin 2019.

Tab. 3 Prodhimi i rasateve (në milionë rasate)

Emërtimi	2019	2020
Koran	1,5	1,6
Krap	1,3	1,3
Ballgjerë i bardhë	1,5	1,5
Ballgjerë Laraman	0,2	0,2
Amur i bardhë	0,2	0,2

Metodologjia

Baza ligjore

- Ligj Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare
- Programi i Statistikave Zyrtare 2017 – 2021
- Regullorja (EC) Nr. 216/2009 mbi “Statistikat e Zënive të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut”
- Regullorja (EC) Nr. 762/2008 mbi “Statistikat e Akuakulturës”

Variablat kryesore grupohen në këto kategori:

- *Zënie peshku sipas kategorive ujore:*
 - a. Detar;
 - b. Bregdet;
 - c. Laguna;
 - d. Ujëra të brendshme;
 - e. Akuakultura.
- *Zëniat sipas specieve kryesore:*
 - a. Açuga;
 - b. Karkalec i thellësisë;
 - c. Merluc;
 - d. Sardele;
 - e. Etj.
- *Flota detare sipas porteve të peshkimit:*
 - a. Durrës;
 - b. Vlorë;
 - c. Saranda;
 - d. Shëngjin;
 - e. Himara;
 - f. Lushnje –Fier;
- *Flota Detare sipas llojt të anijes:*

- a. Me tërheqje (fundore dhe pelagjike);
- b. Me mrezha;
- c. Me koshilok;
- d. Me draga hidraulike;
- e. Me njica;
- f. Anije shumëpërdorimshe;

Burimet e informacionit:

Të dhënat e peshkimit grumbullohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi.

Përkufizime:

Peshkimi

Të dhënat zënie peshku (prodhim peshku dhe akuakultura) grumbullohen sipas kategorive ujore.

Kategoritë ujore të peshkimit janë: peshkimi detar, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe.

Peshkimi detar: Përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës së peshkimit dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Kapaciteti i peshkimit

Është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

Zënie peshku

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Akuakultura

Është rritja e peshkut në kushte artificiale, në të cilin përfshihen: rritje peshku me anë të rasateve, molusqe dhe krustance

Flota

Është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut).

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijeve ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi:

Me tërheqje (fundore dhe pelagjike) - metoda e peshkimit më e rëndësishme dhe një nga më efikasat në botë është ajo me tërheqje. Kjo metodë kryhet si në ujëra të cekëta dhe deri në thellësi 2000 m. Rrjetat tërheqëse përdoren për peshkim fundor dhe pelagjik, në varësi të formës së rrjetës të përdorur.

Procesi i tërheqjes kryhet për një periudhë të caktuar kohe dhe për një distancë të caktuar, deri në tërheqjen e rrjetës lart dhe zbrazjen e saj. Ky mjet peshkimi përdoret kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë.

Me mrezha - Këto anije përdorin rrjeta rrethuese dhe detare dhe përbëjnë një grup të madh të të gjitha madhësive, duke filluar nga anije të hapura, zakonisht të paktën 10 m në gjatësi, deri tek anijet që shkojnë në oqean. Këto zakonisht përdoren për të kapur speciet pelagjike të grumbulluara.

Me koshilok - Përbëjnë një grup anijesh duke përfshirë mjete me të gjitha madhësitë, duke filluar nga varka të vogla deri tek anijet që peshkojnë në oqean. Koshilokët janë mjetet më të rëndësishme dhe më efektive për të zënë specie që grumbullohen pranë sipërfaqes. Mjeti rrethon tufën në anë të rrjetës, më pas pjesa e poshtme e saj mbyllet (nën tufë) me anë të një litari, i cili nisët nga anija, kalon përmes unazave në fund të rrjetës dhe përsëri në anije.

Me draga hidraulike - Dragat janë mjete që gërryejnë fundin e detit për molusqe bivalvë. Dragat përbëhen nga një konstrukt metalik në të cilin kapet thesi i ndërtuar nga unaza metalike ose rrjetë. Dragat mund të tërhiqen me anije ose me krahë. Dragat janë mjete që përdoren në bregdetin e afërt dhe peshkojnë duke qenë në kontakt të fortë me tabanin.

Me njica - Madhësia e anijeve ndryshon në lidhje me zonën e gjuetisë. Këto mjete mund të jenë nga varka të vogla për ujërat e brendshme dhe në bregdet, anije të vogla në kuvertë në ujërat bregdetare dhe anije të mesme që peshkojnë në det të hapur. Në ujërat bregdetare është shumë e zakonshme që kjo formë peshkimii të përdoret si një metodë sekondare sipas sezonit të peshkimit dhe specieve target.

Anije shumëpërdorimshe - mjete peshkimi të cilat përdorin në menyrë të alternuar dy ose më shumë vegla peshkimi pa modifikime të mëdha në anije.

Këto të dhëna janë subjekt rishikimi, për më shumë referohu:

http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf